

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.8

dhjetor 2006

Çfarë mund të presim nga Presidenca Gjermane?

Që prej 1 Janarit 2007 Gjermania ka marrë drejtimin e presidencës së BE-së, e cila, shënon që nga kjo datë një skuadër me 27 shtete, pas aderimit të Bullgarisë dhe Rumanisë. Presidenca, e cila mbahet për 6 muaj mbi bazën e një rotacioni politik dhe gjeografik nga cdo shtet i BE-së, i krijon mundësi këtij të fundit që të përpiqet të jetë-sojë përmes prezantimit të përparësive, ambiciet e tij në rrafshin komunitar. Kancelarja gjermane Angela Merkel ka bërë të qartë planet e saj ambicioze teksa prezantoi programin e presidencës gjermane më 17 Janar 2007 përpara Parlamentit Europian. Këto plane kryesisht konsistojnë në gjetjen e një marrëveshje në lidhje me traktatin kushtetues, progresin drejt politikave më efikase për energjinë sikundër krijimit të lidhjeve më të ngushta midis BE-së dhe vendeve që formalisht kanë qenë pjesë e ish Bashkimit Sovjetik. Gjysma e periudhës së ushtrimit të presidencës gjermane

(vijon në faqen 2)

Nga Veprimtaritë e Kuvendit dhjetor 2006

Kuvendi i Shqipërisë, për muajin dhjetor, në lidhje me fushën e Integritimit Europian, ka miratuar projektligjet e mëposhtme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave sipas neneve të parashikuara nga Kushtetuta (neni 121).

251. Ligj nr. 9671, datë 29.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë".

Ndihma financiare e ofruar nga Bashkimi Europian në kuadër të programit CARDS, është shtylla kryesore mbështetëse e MSA. Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja e Shqipërisë në procesin e integritimit, duke përfshirë mbështetjen për forcimin e Shtetit të së drejtës dhe të stabilitetit demokratik, si dhe zhvillimin ekonomik e social të vendit.

(vijon në faqen 4)

Në këtë numër:

1. Çfarë mund të presim nga
Presidenca Gjermane?

Ditmir Bushati

faqe 1-3

2. Nga veprimtaritë e Kuvendit
dhjetor 2006

faqe 1, 4

3. Nga Veprimtaria e Komisionit
Parlamentar të Integritimit
dhjetor 2006

faqe 1, 5

4. Projektligji "Për auditimin e
brendshëm në sektorin publik"

faqe 6-13

5. Programi i Punimeve të Kuvendit
për periudhën

15 janar - 19 mars 2007

faqe 14-15

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN DHJETOR 2006

Komisioni i Integritimit, për muajin dhjetor, në lidhje me fushën e kompetencës së tij, ka shqyrtuar projektligjet e mëposhtme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave sipas neneve të parashikuara nga Kushtetuta (neni 121).
- Projektligji "Për ratifikimin e një ndryshimi në marrëveshjen e tregtisë së lirë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Institucioneve të Përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës".

Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK), është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 9122, datë 29.07.2003.

(vijon në faqen 5)

Çfarë mund të presim nga Presidenca Gjermane?

(vijon nga faqja 1)

përkon me 50 vjetorin e Traktatit të Romës, i cili themeloi në vitin 1957 Komunitetin Ekonomik Europian. Ky përvjetor festohet në një moment sinjifikativ, kur sipas ambasadorit gjerman në Shqipëri, Hans Peter Anen "BE-së i duhet të vijojë rrugën e reformave që janë ngadalësuar pak me referendimet për kushtetutën në Francë dhe Holandë".

Pritshmëritë nga administrimi

Pas një viti ku presidenca e BE-së është ushtruar nga shtete relativisht të vogla si Austria dhe Finlanda, shtetet anëtare të BE-së, por edhe ato që aspirojnë anëtarësimin apo një intensifikim të marrëdhënieve tregtare me të, shpresojnë se Gjermania do të mund t'i japë një shtytës reformave europiane, duke pasur në vëmendje fuqinë politike dhe ekonomike të Gjermanisë, duke mos nënvleftësuar gjithashtu faktin se kemi të bëjmë me një shtet themelues të BE-së. Në dallim nga shtetet e vogla, ushtrimi i presidencës nga shtetet e mëdha, megjithëse shpesh jo fort konsensual, krijon mundësi për një administrim më të mirë të axhendës europiane dhe momentum-it politik.

Mjafton të përmendim këtu se Gjermanisë do t'i duhet të drejtojë rreth 4.000 takime brenda strukturave të BE-së dhe rreth 40 takimeve me shtete jo anëtare të BE-së, duke përfshirë samitet me Rusinë, Japoninë, Kanadanë dhe SHBA, për të kuptuar mekanizmin burokratik dhe politik që nevojitet për të përballuar me sukses përgjegjësitë që rrjedhin nga të qenit timonier i BE-së për 6 muaj.

Por, ushtrimi i presidencës nga shtete të mëdha shoqërohet edhe me riskun e dështimit në rast se nuk arrihen të gjithë objektivat ambiciozë të bërë publik në fillimin e presidencës. Duke qenë se opinioni publik ushqehet nga faktori mediatik dhe politik me pritshmëri të mëdha, edhe perceptimi i zhgënjimit për cdo pamundësi që haset rrugës rrezikon të ketë një efekt bumerang për suksesin e presidencës.

Gjermania do t'ia dorëzojë stafetën Portugalisë dhe Slllovenisë dhe vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2008 do të jetë një tjetër shtet i madh si Franca që do të përpiqet të orientojë axhendën europiane drejt sfidave të reja. Gjithsesi, sistemi i "presidencës trio" siguron një bashkëpunim, vazhdimësi dhe kohërencë më të madhe ndërmjet shteteve në funksion të arritjes së objektivave të përbashkëta. Nga ana tjetër, nuk mund të mohohet fakti se shtetet e vogla gjatë ushtrimit të presidencës kanë korrur jo pak suksese duke u rrethuar nga një konsensus më i madh ndërshtetëror.

Problemet e leadership-it

Opinionin publik europian e pret me entuziazëm presidencën gjermane edhe për faktin se në shtetet e tjera të mëdha anëtare të BE-së, debati politik i brendshëm ka fituar tërren në raport me çështjet europiane. Kështu, në mesin e vitit 2007 kryeministri britanik Tony Blair pritet të tërhiqet nga drejtimi i qeverisë dhe partisë laboriste, e rrjedhimisht nga jeta aktive politike të cilën e ka dominuar për më shumë se një dekadë. Në Francë, gjatë periudhës prill-maj 2007 do të zhvillohen zgjedhjet presidenciale, të cilat do të pasohen me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në qershor të të njëjtit vit. Holanda vazhdon të drejtohet nga një qeveri kujdestare,

pas kolapsit që pësoi koalicioni i qendrës së djathtë në qershorin e vitit 2006.

Në Itali, koalicioni i qendrës së majtë drejtuar nga Romano Prodi shfaqet i fragmentuar cka e pengon Italinë të shfaqet me peshën reale në rrafshin europian. Megjithatë, Romani Prodi, ndoshta edhe për shkak të eksperiencës së mëparshme si President i Komisionit Europian sikundër vokacionit të tij thellësisht europian, nuk ka hezitur të shfaqet në shtypin europian në mbështetje të përshpjetimit të hapava që do të mundësonin anëtarësimin e Kroacisë dhe Maqedonisë në BE, duke hapur rrugën edhe për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Interesat e Spanjës për momentin duken të përqendruara më së shumti në çështjet e brendshme të përballjes me terrorizmin se sa në ato europiane, fakt që u demonstrua qartë edhe me debatin parlamentar midis kryeministrit socialist Zapatero dhe opozitës konservative pas prishjes së armëpushimit me ETA-n. E njëjta gjë mund të thuhet për Poloninë e cila duket e mbërthyer në retorikën obstruksioniste dhe populiste, cka sipas Ivan Krastevit, "të krijon përshtypjen se Lufta e Dytë Botërore ende nuk ka mbaruar".

E ardhmja e zgjerimit në kontekstin e presidencës gjermane

Mosmarrëveshjet brenda koalicionit të madh qeverisës në Gjermani duket se nuk kanë pasur efekt në raport me politikën e BE-së. I vetmi përjashtim është Turqia, ku kristian demokratët e kancelares Merkel në dallim nga socialdemokratët favorizojnë një partneritet të privilegjuar për Turqinë dhe jo antarësimin e saj të plotë në BE. Por, duket se pas pezullimit të pjesshëm të negociatave për antarësim me Turqinë në dhjetorin e vitit 2006, zgjerimi për momentin nuk është pjesë e axhendës europiane.

Sa i përket shteteve të Ballkanit Perëndimor qëndrimi gjerman është pasqyrim i Strategjisë së Zgjerimit, publikuar nga Komisioni Europian më 8 nëntor 2006, ku thuhet mjaft qartë se performanca e cdo vendi që aspirojnë antarësimin do të analizohet në përputhje me "regatta principle", pra me meritat individuale të gjithsecilit.

E natyrisht, diferencat në Ballkanin Perëndimor ekzistojnë, pasi Kroacia është në tryezën e negociatave për antarësim me BE-në. Maqedonia ka fituar statusin e vendit kandidat por nuk ka siguruar ende një datë për fillimin e negociatave, për shkak të uljes së ritmit të reformave. Shqipëria ka nënshkruar MSA-së dhe ndodhet para një testi të rëndësishëm në lidhje me respektimin e standardeve zgjedhore sikundër me zbatimin korrekt të Marrëveshjes së Përkohshme që hyri në fuqi më 1 Dhjetor 2006. Serbia pret me padurim rifillimin e negociatave cka do t'i mundësonin asaj jo thjesht nënshkrimin e MSA-së por edhe avancimin në etapat e mëtejshme të procesit drejt fitimit të statusit të vendit kandidat, duke njohur kapacitetet institucionale që posedon. Për Kosovën vëmendja e BE-së dhe presidencës gjermane është përqendruar fillimisht tek statusi përfundimtar, duke rikonfirmuar perspektivën europiane të saj. Bosnia dhe Mali i Zi shpresojnë që të nënshkruajnë MSA-në brenda vitit 2007. Gjithsesi, duket se e ardh-

(vijon në faqen 3)

Çfarë mund të presim nga Presidenca Gjermane?

(vijon nga faqja 2)

mja e zgjerimit kushtëzohet nga gjetja e kompromisit për traktatin kushtetues për të mundësuar elasticitetin e nevojshëm në pjesëmarrjen edhe të shteteve të tjera në institucionet komunitare.

Axhenda e Lisbonës dhe reformat e brendshme

Dy vjet pas rishikimit të Axhendës së Lisbonës e cila synon ta kthejë BE-në brenda vitit 2010 në ekonominë më konkurruese në botë, Gjermania kërkon që një pjesë të objektivave të Lisbonës të tilla si: liberalizimi i tregjeve të energjisë, mundësitë e barabarta në tregun e punës dhe një reformë rregullatore në fushën e biznesit, të përbëjnë prioritetet thelbësore të BE-së në fushën e ekonomike. Madje, përparësia absolute duket se është tregu i energjisë ku Gjermania premtim hartimin e një "road map", cka do t'i krijonte mundësi BE-së që të mos ndodhej në pozita varësie me vende të caktuara në lidhje me tregun e energjisë.

Gjermania propozon gjithashtu krijimin e një komisioni me ekspertë të pavarur për të vlerësuar impaktin e akteve legjislative të BE-së. Gjermania e ka krijuar një institucion të tillë me ekspertë të pavarur në rrafshin kombëtar, ndaj mendon se edhe BE-ja do të krijonte një precedent pozitiv në rast se aktet ligjore gjatë përgatitjes së tyre do të studioheshin nga ekspertë të pavarur dhe jo nga zyrtarë të Komisionit Europian. Në lidhje me procesin ligjvënës brenda BE-së, Gjermania propozon aplikimin e "parimit të shkëputjes", cka do të thotë se në të ardhmen, gjatë mandatit 5 vjeçar të Komisionit dhe Parlamentit së bashku me Këshillin nuk kanë pse të rimarrin për diskutim apo miratim akte ligjore që nuk kanë arritur të miratohen nga këto institucione gjatë ushtrimit të mandateve pararendëse.

Politika e jashtme dhe e sigurisë

Në lidhje me politikën e jashtme dhe të sigurisë, Gjermania shpreson që BE-ja dhe Rusia do të gjejnë gjuhën e përbashkët për nënshkrimin e një marrëveshje bilaterale që do të zëvendësonte Marrëveshjen e Partneritetit dhe Bashkëpunimit, e cila, skadon në nëntor të vitit 2007. Gjermania kërkon gjithashtu të rivitalizojë Politikën Europiane të Fqinjësisë me qëllim stabilizimin e vendeve kufitare, duke i përfshirë ato në një proces më të thellë integrimi në sektorë të vecantë si energjia dhe transporti. Risia kryesore në politikën e jashtme qëndron padyshim në formulimin për herë të parë të një strategjie nga ana e BE-së për Azinë Qendrore. Ndërkohë, që SHBA, Rusia dhe Kina janë përfshirë në plane që synojnë shtrirjen e influencës në këtë zonë, europianët kanë qenë thuajse jo prezent për dekada të tëra. Në mënyrë më specifike, Gjermania kërkon një bashkëpunim më të ngushtë me vende të tilla si Uzbekistani, Kazakistani dhe Turkmenistani, në lidhje me luftën kundër terrorizmit, trafikimit, migracionit, stabilitetit rajonal, transportit dhe energjisë. Por, përpjekjet për të ndërtuar ura më të qëndrueshme komunikimi me këto vende që përfaqësohen nga qeverisje autoritariste mund të sjellë reagimin e vendeve nordike anëtare të BE-së, të cilat, tradicionalisht kanë kushtëzuar bashkëpunimin në politikën e jashtme me respektimin e të drejtave të njeriut.

Siguria e brendshme dhe emigracioni

Në lidhje me çështjet e sigurisë së brendshme dhe të emigracionit, me gjithë ngurimin e kahershëm gjerman

për të avancuar më tej me bashkëpunimin midis shteteve anëtare të BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, pjesa më e madhe e shteteve anëtare janë të bindur se nevojitet një bashkëpunim më i gjerë në lidhje me politikën e migracionit, kontrollin kufitar dhe luftën kundër krimit dhe terrorizmit. Frika e opinionit publik europian ndaj terrorizmit dhe valëve të reja të emigracionit do të imponojnë mbajtjen e çështjeve të drejtësisë dhe punëve të brendshme si pjesë të axhendës.

Rilindja e Kushtetutës

Shumë studjues nuk kanë nguruar ta përkufuzojnë presidencën gjermane si periudhën e "rilindjes së Kushtetutës", duke analizuar disa skenarë që do të mundësonin rigjetjen e kompromisit tek teksti ekzistues, duke mos cënuar në të njëjtën kohë imazhin e vetë BE-së. Kancelarja gjermane Angela Merkel ka shprehur shumë qartë vullnetin e presidencës për të gjetur një zgjidhje të pranueshme midis vendeve anëtare të BE-së. Pikënisja, sipas presidencës gjermane, duhet të jetë teksti ekzistues. Interesant është fakti se Presidenti gjerman ka refuzuar të dekretojë tekstin e traktatit kushtetues, pasi Gjykata Kushtetuese gjermane refuzoi të shprehej mbi ankimin e depozituar nga një deputet gjerman, me pretendimin se nuk mund të shprehej për sa kohë të gjitha vendet anëtare të BE-së të binin dakord se çfarë do të bënin me këtë traktat.

Edhe për këtë arsye, presidenca gjermane synon që të arrihet një marrëveshje, e cila, do të mundësonte hyrjen në fuqi të traktatit kushtetues përpara zgjedhjeve të Majit 2009 për në Parlamentin Europian dhe përpara rinovimit të Komisionit Europian. Ky objektiv ambicioz imponon organizimin e një konferencë ndërqeveritare brenda gjysmës së dytë të vitit 2007, me qëllim që brenda vitit 2008 të jetë ratifikuar teksti kushtetues nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Një gjë e tillë mund t'i interesojë edhe qeverisë britanike e cila mund të kërkojë një zgjidhje të shpejtë për të ardhmen e traktatit kushtetues, me qëllim shmangien e çështjeve europiane nga zgjedhjet parlamentare që priten të mbahen në vitin 2009. Por, problemi duket se qëndron për momentin tek Franca e cila e ka thuajse të pamundur të përfshihet në një debat thelbësor për të ardhmen e traktatit kushtetues përpara zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të majit dhe qershorit të vitit 2007.

Sikurse shihet qartë nga natyra e çështjeve dhe problemeve të mprehta me të cilat përballet BE-ja sot, pritshmëritë ndaj presidencës gjermane janë rritur natyrshëm. Kësisoj, presidenca gjermane duket se është e destinuar të cojë përpara projektin europian duke u rishfaqur edhe një herë si faktori unifikues i kontinentit.

Shënime

¹ Intervistë e ambasadorit gjerman në Republikën e Shqipërisë Hans Peter Anen dhënë Radio Televizionit Shqiptar në datën 26.01.2007.

² Shih, Ivan Krastev, *The revolt of the masses*, Wall Street Journal, 27 September 2006.

Ditmir Bushati

Nga Veprimtaritë e Kuvendit për muajin dhejtor 2006

(vijon nga faqja 1)

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë:

Komisioni për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.

Komisioni i Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Projektligji është miratuar në seancë plenare.

246. Ligj nr. 9666, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e një ndryshimi në marrëveshjen e tregtisë së lirë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Institucioneve të Përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës".

Marrëveshja e tregtisë së lire ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK), është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 9122, datë 29.07.2003.

Synimi i ndryshimit të propozuar në këtë projektligj është thellimi i liberalizimit të tregtisë ndërmjet subjekteve negociuese për produktet industriale dhe bujqësore, mbi baza të ndërsjella përfitimi dhe zgjerimi i tregtisë dhe marrëdhënieve ekonomike.

Si rrjedhojë të negociatave, tarifat doganore për importet e produkteve industriale dhe bujqësore, të zbatueshme në Kosovë, për produktet industriale dhe bujqësore, me origjinë nga Republika e Shqipërisë të specifikuar në aneksin III të MTL do të bëhen 0 me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve. Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë:

Komisioni për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.

Komisioni i Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Komisioni i Integritimit Europian.

Komisioni për veprimtaritë prodhuese, tregtinë dhe mjedisin.

Projektligji është miratuar në seancë plenare.

238. Ligj nr. 9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtarë të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të

Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian".

Marrëveshja mes vendeve siç është e parashikuar në titullin e projektligjit parashikon për palët kontraktuese disa detyrime të cilat mund të ndahen në tre drejtime: detyrime për ndryshimin e strukturave aktuale, detyrime për ndryshimin e legjislacionit, si dhe krijimin e një njësie për sistemin rregullator.

Për Republikën e Shqipërisë ka një shtojcë të veçantë në të cilën parashikohen dy faza për implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Faza e parë është një periudhë tranzitore, 2006-2007, ku do të sigurohet *safety* dhe *security*, do të krijohet Autoriteti i Aviacionit Civil si njësi e re për hetimin mbi incidente dhe për dokumentacionin.

Faza e dytë parashikon sistemimin e legjislacionit, duke përfshirë edhe mbrojtjen e konsumatorit.

Marrëveshja parashikon kushtet për të marrë pjesë në bashkëpunim pa kufizim të ndërsjellë mes partnerëve të barabartë.

Qeveria duhet të përgatisë legjislacionin në vazhdim për implementimin e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja nuk ka detyrime financiare. Kostoja financiare që rrjedh nga kjo marrëveshje është vetëm ajo që nevojitet për ndryshimin e strukturave.

Para kalimit në seancë plenare për miratim, projektligji është marrë në shqyrtim nga komisionet e përhershme që me poshtë vijojnë:

Komisioni për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.

Komisioni i Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Komisioni i integritimit evropian.

Komisioni për veprimtaritë prodhuese, tregtinë dhe mjedisin.

Projektligji është miratuar në seancë plenare.

Në datat 18-19 dhjetor, të deleguar të Kuvendit kanë marrë pjesë në një Kolokium ndërparlamentar të organizuar nga Parlamenti Europian, drejtorja e marrëdhënieve me Parlamentet Kombëtare, mbi temën: "Edukimi dhe Rinia – një prespektivë europiane".

Në këtë takim ishin të ftuar Parlamentet e vendeve të Ballkanit Perendimor, si Shqipëria, Bosnia Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

Gjatë takimit u diskutua mbi Aktivitetet e Drejtorisë për Marrëdhëniet me Parlamentet Kombëtare të Parlamentit Europian, rolin e edukimit në procesin e integritimit evropian mbi Kërkimin dhe Rininë si prespektivë për Ballkanin perendimor. Programi i 7-të

(vijon në faqen 5)

Nga Veprimtaritë e Kuvendit për muajin dhjetor 2006

(vijon nga faqja 4)

kuadër 2007 – 2013, mbi ndërtimin e kapitalit njerzor: një prioritet rajonal i Paktit të Stabilitetit për Ballkanin Perendimor, mbi Strategjinë e Komisionit European në fushën e Edukimit dhe Rinisë – Sukseset dhe ndryshimet e programeve të shkëmbimit të komuniteteve, mbi Synimet e Presidencës së Finlandës në BE në fushën e politikës europiane për Edukimin dhe Rininë, mbi Programet e Komisionit European në fushën e Edukimit dhe Rinisë për vendet e Ballkanit Perendimor mbi rolin e Parlamenteve Kombëtare në promovimin e politikave për Rininë dhe Edukimin, mbi Prespektivat e Punësimit për të diplomuarit e ri si dhe Parandalimi i braktisjes së shkollës dhe tharja e trurit.

Parlamenti European nëpërmjet Drejtorisë për marrëdhëniet me parlamentet kombëtare, ka mundësuar takime me Komisionet parlamentare, kolokiume dhe ka mundësuar takime direkte mes interlokutorëve. Po në këtë drejtim është munduar të marrë dëshminë e institucioneve të ndryshme, të ndërtojë programe bashkëpunimi si dhe kërkime shkencore.

Si rezultat i kësaj pune rrjedhin disa rekomandime, duhet të forcohet dialogu ndërparlamentar për arsimin dhe rininë. Rëndësi të madhe ka kërkimi shkencor dhe studimi. Mbi këto çështje duhet përdorur parimi i subsidiaritetit. Në planin kombëtar duhen ngritur sisteme arsimit të pavarura, duhet rritur shkëmbimi i informacioneve, duke mbajtur parasysh strategjinë e Lisbonës. Iniciativa e presidencës austriake dhe vazhdimësia e presidencës finlandeze duhet të ndihmojë në rrijen e shkëmbimit të studentëve dhe të profesorëve. Për arrijten e këtij qëllimi, thjeshtësimi i procedurave dhe lehtësimi i marrjes së vizave janë të domosdoshme, por gjithnjë duke patur parasysh kontrollat e duhura dhe të forta për të mos lejuar trafikimet e ndryshme.

Një pikë tjetër ishte harmonizimi i modeleve arsimore. Për këtë çështje duhen mundësuar takime rajonale dhe komunikim ndërkulturor. Sistemet arsimore duhet të ruajnë individualitetin por gjithmonë duhet të mbajnë parasysh harmonizimin për njohjen reciproke të diplomave. Kjo është kompetence e institucioneve kombëtare.

Një element për realizimin e samësipërm është thjeshtësimi i marrëdhënieve mes parlamenteve kombëtare.

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN DHJETOR 2006

(vijon nga faqja 1)

Synimi i ndryshimit të propozuar në këtë projektligj është thellim i liberalizimit të tregtisë ndërmjet subjekteve negociuese për produktet industriale dhe bujqësore, mbi baza të ndërsjella përfitimi dhe zgjerimin e tregtisë dhe të marrëdhënieve ekonomike.

Si rrjedhojë e negociatave tarifave doganore për importet e produkteve industriale dhe bujqësore, të zbatueshme në Kosovë, për produktet industriale dhe bujqësore, me origjinë nga Republika e Shqipërisë të specifikuar në aneksin III të MTL do të bëhen 0 me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve.

- Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit European dhe shteteve anëtarë të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit european".

Marrëveshja mes vendeve siç është e parashikuar në titullin e projektligjit parashikon për palët kontraktuese disa detyrime të cilat mund të ndahen në tre drejtime: detyrime për ndryshimin e strukturave aktuale, detyrime për ndryshimin e legjislacionit, si dhe krijimin e një njësie për sistemin rregullator.

Për Republikën e Shqipërisë ka një shtojcë të veçantë në të cilën parashikohen dy faza për implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Faza e parë është një periudhë tranzitore, 2006-2007, ku do të sigurohet *safety* dhe *security*, do të krijohet Autoriteti i Aviacionit Civil si njësi e re për hetimin mbi incidente dhe për dokumentacionin.

Faza e dytë parashikon sistemimin e legjislacionit, duke përfshirë edhe mbrojtjen e konsumatorit.

Marrëveshja kushtet për të marrë pjesë në bashkëpunim pa kufizim të ndërsjellë mes partnerëve të barabartë.

Qeveria duhet të përgatisë legjislacionin në vazhdim për implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja nuk ka detyrime financiare. Kostot financiare që rrjedhin nga kjo marrëveshje është vetëm ajo që nevojitet për ndryshimin e strukturave.

Projektligji “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

RELACION PËR PROJEKTLIGJIN “PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”

Ministria e Financave, si përgjegjëse për krijimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, në tërësi, dhe atij të auditimit të brendshëm, në veçanti, me shqetësimin dhe përgjegjësinë për të realizuar një kthesë rrënjësore në fushën e administrimit ligjor, transparent dhe efektiv të fondeve publike, në bazë të matricës së akteve ligjore, për vitin 2006, ngriti grupin e punës për rishikimin e ligjit ekzistues për auditimin e brendshëm në sektorin publik, grup i cili u kryesua nga zëvendësministri i Financave.

Në këtë grup pune u përfshinë ekspertët më të mirë të sistemit financiar për vendin, duke synuar përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe realizimin e një procesi sa më të hapur dhe sa më gjithëpërfshirës. Nga takimet e para të grupit të punës u arrit në përfundimin se në ligjin nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, duheshin bërë ndryshime të theksuara, për t’i paraprirë zgjidhjes dhe funksionimit normal të procesit të auditimit në sektorin publik, dhe se ishte i nevojshëm hartimi i një projektligji të ri në këtë fushë.

Hartimi i projektligjit të ri për auditimin e brendshëm në sektorin publik u bazua në reformat në fusha të ndryshme të financave publike, të cilat kërkonin një institucionalizim ligjor më të plotë, si dhe në kërkesat për një përcaktim më të qartë të fushës së zbatimit të ligjit të objektit të punës së auditimit të brendshëm, të mënyrës së organizimit dhe të kompetencave të strukturave të auditimit dhe, veçanërisht, të komitetit të auditimit të brendshëm e të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit, si dhe të marrëdhënieve të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit me institucionet e tjera.

Projektligji i ri synon përmirësimin e standardeve të punës, për realizimin e procedurave të auditimit në përputhje me ato ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira të vendeve të BE-së, me qëllim plotësimin e kërkesave për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit European.

Në hartimin e këtij projektligji është bashkëpunuar me qendrat e specializuara dhe me ekspertë të shquar, brenda dhe jashtë vendit, dhe veçanërisht me ekspertët e projektit PIFC, “Për kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP)”, i drejtuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, Angli, dhe Ministria e Financave, e Holandës, dhe i financuar nga Bashkimi European, në kuadër të programit CARDS-2001.

Projektligji mishëron përvojën pozitive të krijuar deri më sot. Gjithashtu, projektligji siguron përmirësimet e mundshme, të propozuara nga KLSH-ja dhe ekspertët të ministrive të linjës, pushteti vendor, sho-

qëria civile, bota akademike. Në hartimin e projektligjit janë marrë parasysh mendimet e institucioneve financiare ndërkombëtare siç janë: FMN-ja, BB-ja, BE-ja, SIGMA, USAID-i dhe së fundmi komentet nga Brukseli. Gjithashtu, ky projektligj synon të zgjidhë probleme, që has sistemi i auditimit në vendin tonë. Kështu disa nga fushat, që do të gjejnë reflektim më të plotë dhe që përbëjnë përparësi për qeverinë në këtë fushë janë, si më poshtë vijon:

- Qartësimi i konceptit të auditimit të brendshëm e i kontrollit të

brendshëm, si dhe i fushës së zbatimit të këtij ligji në sektorin publik.

Ndryshe nga ligji ekzistues fusha e zbatimit të këtij projektligji

përfshin auditimin e të ardhurave, fondeve buxhetore, donacioneve

ndërkombëtare apo bashkëfinancimet në të gjithë sistemin publik;

- Përcaktimi i objektit të punës së strukturave të auditimit, i cili ka të

bëjë me të gjitha vendimet financiare për të ardhurat, shpenzimet,

administrimin e pasurive (asetet) dhe borxhet;

- Roli i komitetit të auditimit të brendshëm, si organ këshillimor, pranë

ministrit të Financave. Ky komitet merr funksione më të qarta dhe

zgjerohet në numër dhe funksione, duke siguruar një përfaqësim më të

mirë në sistemin publik dhe pavarësi në vendimmarrje;

- Qartësimi i rolit, misionit, varësisë dhe kompetencave të Drejtorisë së

Përgjithshme të Auditimit dhe shmangia e personifikimit të sistemit të

auditimit me pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit. Në

strukturën dhe përbërjen organike të kësaj drejtorie përfshihet edhe

njësia qëndrore e harmonizimit, e cila organizohet në nivel drejtorie,

kërkesë kjo e Bashkimit European, për përafrimin e legjislacionit

shqiptar me kërkesat e *acquis communautaire*. Njësia qëndrore e

harmonizimit do të auditojë të gjitha fondet, që do të jepen tashmë nga

BE-ja për vendin tonë.

- Përcaktimi i një ndarjeje të qartë të përgjegjësive, ndërmjet ministrit të

Financave dhe drejtuesve të tjerë të institucioneve publike;

(vijon në faqen 7)

Projektligji “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

(vijon nga faqja 6)

- Përcaktimi i mënyrës së krijimit dhe funksionimit të strukturave të auditimit, përcaktimi i varësisë së tyre, e cila është e dyfishtë në organin e emërtesës dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, si dhe përcaktimi i strukturës bazë, që përgjigjet për udhëheqjen metodologjike dhe harmonizimin e veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm, në shkallë vendi. Po kështu, të gjitha strukturat e auditimit në sektorin publik janë të detyruara të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, në përputhje me dispozitat ligjore për raportimin dhe me procedurat e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe të miratuara nga ministri i Financave.
- Krijimi i kapaciteteve dhe rritja e nivelit profesional të personelit të angazhuar në këtë sistem. Kualifikimi i personelit, nëpërmjet edukimit të përditësuar e trajnimit të vijueshëm, të detyrueshëm, dhe sidomos rritja e performancës së tyre, nëpërmjet sistemit të certifikimit, përbëjnë një problem për vitet në vijim, për të siguruar një pavarësi dhe integritet, profesional e moral, sipas kërkesave të standardeve bashkëkohore;
- Marrëdhëniet e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit me institucionet e tjera, ku janë përcaktuar edhe detyrimet dypalëshe. Në mënyrë të veçantë i është kushtuar rëndësi bashkëpunimit me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, KLSH-në dhe institucionet e tjera të pavarura, të cilat duhet të organizojnë veprimtarinë e auditimit në strukturat e tyre, në përputhje me kriteret, që do të miratohen, në zbatim të këtij ligji, me vendim të Këshillit të Ministrave. Në një nen të veçantë janë pasqyruar edhe marrëdhëniet me ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor. Hartimi i këtij projektligji është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përballimin e sfidës së qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe fenomeneve

të tjera negative, si edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Miratimi i tij do të sigurojë mundësinë e një funksionimi më normal të sistemit të auditimit, një rritje cilësore në realizimin e misionit të auditimit të brendshëm, në shkallë vendi, në kuadrin e kontrollit të brendshëm financiar dhe një harmonizim dhe përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, të pranuar të auditimit dhe praktikave më të mira të Bashkimit Europian.

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTLIGJ PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet në të gjitha institucionet e sektorit publik, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike (shtetërore) e që, gjatë funksionimit, përdorin fonde nga buxheti i shtetit a nga organizmat ndërkombëtare, apo fonde të përfituara në formë bashkëfinancimi.

Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, organet e pushtetit vendor, institucionet e tjera, qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucionet e pavarura e shoqëritë tregtare, apo të çdo forme tjetër, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind.

Subjektet e përmendura në paragrafin e dytë, të këtij neni, në vijim do të quhen “subjekte të audituara”.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme të funksionimit të auditimit

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që siguron menaxhimin dhe këshillon për veprimtarinë drejtuese, për përdorimin efektiv të fondeve dhe përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara. Auditimi i brendshëm ndihmon subjektet e audituara në mënyrë, sistematike dhe të programuar, për

(vijon në faqen 8)

Projektligji "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"

(vijon nga faqja 7)

të përmirësuar përdorimin efektiv të fondeve, për të vlerësuar riskun, performancën, sistemet e kontrollit dhe ato të drejtimit.

Auditues i brendshëm, që në vijim do të quhet "auditues", është profesionisti, i kualifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

Kontrolli i brendshëm është procesi i përcaktimit të politikave, i funksionimit, procedurave dhe të organizimit të punës, për të ndihmuar dhe siguruar drejtimin, që programet të arrijnë rezultatet e synuara, duke përdorur burimet dhe asetet, pronë publike, në përputhje me qëllimet dhe objektivat, që ato të jenë të mbrojtura nga shpenzimet e pajustificuara, nga keqadministrimet e mashtrimet e, që, për vendimmarrjen, përftohen, përdoren, raportohen e administrohen të dhëna të besueshme dhe bashkëkohore.

Drejtimet kryesore të auditimit lidhen me:

- a) përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve, financiare dhe njerëzore;
- b) riskun e kontrollit të drejtimit;
- c) shkallën në të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij;
- ç) pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi;
- d) kujdesin për plotësimin e të dhënave, financiare dhe të drejtimit, si dhe përdorimin e tyre në mbështetje të vendimmarrjes;
- dh) ruajtjen dhe miradministrimin e asetëve, pronë publike.

Sipas këtij neni me:

- kursim nënkuptohet përdorimi me masë i burimeve të veprimtarisë, duke ruajtur cilësinë;
- dobi nënkuptohet lidhja ndërmjet rezultatit të shprehur në mallra, shërbime ose prodhime të tjera dhe burimeve të përdorura për t'i siguruar ato;
- frytshmëri nënkuptohet niveli i realizimit të objektivave dhe raporti i rezultatit të pritur me rezultatin faktik të veprimtarisë.

Neni 4

Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit

Auditimi i brendshëm në sektorin publik mbështetet në parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë dhe fshehtësisë.

"Zbatimi i parimit të ligjshmërisë", nënkupton respektimin e Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

"Zbatimi i parimit të pavarësisë", nënkupton ushtrimin e veprimtarisë për përcaktimin, planifikimin, realizimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit, jashtë çdo ndikimi, që ka lidhje me veprimtarinë e au-

dituar apo rrethanat, që çënojnë apo mund të çënojnë objektivitetin. Vlerësimi për objektivitetin administrohet, në radhë të parë, nga vetë individit, në rolin e audituesit, dhe më pas nga strukturat eprore.

"Zbatimi i parimit të paanësisë", nënkupton pasqyrimin, objektiv dhe transparent, në dokumentet përkatëse, të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të audituara, pa u ndikuar nga interesi personal ose pikëpamjet e të tretëve.

"Zbatimi i parimit të fshehtësisë", nënkupton trajtimin si konfidencial të të dhënave të tjera, të administruara gjatë auditimit, sipas parashikimeve të pikës 8, të nenit 20, të këtij ligji.

Neni 5

Standardet e auditimit të brendshëm

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik bazohet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Ministri i Financave, me propozimin e komitetit të auditimit të brendshëm, shpall standardet e auditimit të brendshëm.

Neni 6

Objekti i punës së auditimit të brendshëm

1. Objekt i punës së auditimit të brendshëm janë të gjitha vendimet financiare për të ardhurat, shpenzimet, administrimin e pasurive (aseteve) dhe borxheve. Auditimi i brendshëm, si një proces dhe veprimtari e pavarur nga pikëpamja funksionale, vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozohen masa, për të përmirësuar funksionimin dhe drejtimin e subjekteve të audituara.

2. Planifikimi në proceset e auditimit të brendshëm nuk kufizon kryerjen e auditimeve, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në programin vjetor apo strategjik.

Neni 7

Manuali i procedurave të auditimit të brendshëm

Procedurat dhe metodat e auditimit parashikohen në manualin e procedurave të auditimit të brendshëm, i cili në vijim do të quhet "Manuali i auditimit", që miratohet nga ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Neni 8

Sistemi i auditimit të brendshëm në sektorin publik Sistemi i auditimit të brendshëm në sektorin publik përbëhet nga:

1. Ministri i Financave;

(vijon në faqen 9)

Projektligji "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"

(vijon nga faqja 8)

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm;
3. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit;
4. Njësitë e auditimit të brendshëm pranë subjekteve të audituara, sipas përcaktimit të bërë në nenin 2, të këtij ligji.

KREU II

KOMITETI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 9

Qëllimi i komitetit të auditimit të brendshëm

Komiteti i auditimit të brendshëm është organ këshillimor pranë ministrit të Financave dhe ka si qëllim propozimin dhe dhënien e këshillave për përcaktimin e strategjive dhe përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, në sektorin publik.

Neni 10

Funksionet e komitetit të auditimit të brendshëm

Funksionet e komitetit të auditimit të brendshëm janë:

- a) Përgatitja dhe dhënia e vlerësimeve e të mendimeve për metodat e auditimit të brendshëm, të propozuara nga drejtori i Përgjithshëm i Auditimit;
- b) Vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për kuadrin, ligjor dhe rregullator, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit në fushën e auditimit të brendshëm, në sektorin publik;
- c) Vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për raportet, tremujore dhe vjetore, të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit;
- ç) Këshillimi i ministrit të Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së auditimit të brendshëm, në përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara;
- d) Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për rishikimin e metodave, të procedurave dhe përshtatjen e standardeve të auditimit të brendshëm, të propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit, përpara miratimit nga ministri i Financave;
- dh) Kryerja e detyrave të tjera, të caktuara nga ministri i Financave.

Neni 11

Organizimi i komitetit të auditimit të brendshëm

1. Komiteti i auditimit të brendshëm përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët përzgjidhen dhe emërohen nga ministri i Financave, si më poshtë vijon:

- a) Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit;
- b) Tre profesionistë nga fusha e auditimit të brendshëm publik, nga të cilët njëri nga strukturat audituese të organeve të pushtetit vendor;

c) Dy përfaqësues nga fusha akademike, të lidhura me auditimin;

ç) Një jurist, përfaqësues nga strukturat përkatëse;

d) Një përfaqësues nga strukturat e kontrollit të menaxhimit financiar;

dh) Një përfaqësues, ekspert, me kualifikim të lartë, i përzgjedhur nga organizmat profesionale, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm.

2. Anëtarët e komitetit të auditimit të brendshëm emërohen për një periudhë jo më pak se dy vjet dhe jo më shumë se katër vjet. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit siguron mbështetjen teknike, përmes sekretariatit të këtij komiteti.

3. Anëtarët e komitetit të auditimit të brendshëm, në mbledhjen e tyre të parë, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedhin kryetarin. Kryetari i komitetit të auditimit të brendshëm nuk duhet të jetë punonjës i strukturave të auditimit të brendshëm. Mandati i tij zgjat 2 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

4. Mbledhjet e komitetit të auditimit të brendshëm organizohen jo më pak se një herë në dy muaj. Mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Votimi merret me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Në rast ndarjeje të barabartë të votave, vota e kryetarit të komitetit të auditimit të brendshëm është përcaktuese.

5. Kur diskutohen çështje të rëndësishme të veçantë, të parashikuara nga shkronjat "a", "b", "ç" e "d", të nenit 10, të këtij ligji, për vlefshmërinë e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja të paktën e shtatë anëtarëve, ndërsa vendimi nuk mund të merret pa siguruar votën pro të pesë anëtarëve të pranishëm.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, miraton rregulloren e funksionimit dhe masën e shpërblyerjes të anëtarëve të komitetit të auditimit të brendshëm.

KREU III

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AUDITIMIT

Neni 12

Vartësia e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit është pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave. Ajo drejton dhe menaxhon veprimtarinë e auditimit të brendshëm, për sektorin publik, në Republikën e Shqipërisë.

Struktura organike dhe numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Financave. Në strukturën dhe përbërjen organike të Drejtorisë

(vijon në faqen 10)

Projektligji "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"

(vijon nga faqja 9)

së Përgjithshme të Auditimit funksionon edhe njësia qëndrore e harmonizimit, e organizuar në nivel drejtorie. Punonjësit e kësaj njësie nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në auditimin e subjekteve të audituara. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili ka statusin e nëpunësit civil.

Neni 13

Kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit ushtron këto kompetenca:

- a) Zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari, në nivel kombëtar;
- b) Zhvillon dhe përmirëson legjislacionin, kryesor dhe mbështetës, për auditimin e brendshëm publik, në bashkëpunim me strukturat e tjera të kësaj ministrie;
- c) Zhvillon metodat e auditimit për përcaktimin dhe vlerësimin e riskut dhe të performancës;
- ç) I propozon komitetit të auditimit të brendshëm dhe ministrit të Financave rishikimin e manualit të auditimit, të urdhërave, udhëzimeve dhe të procedurave të auditimit, për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me kërkesat e legjislacionit të vendeve të Bashkimit Europian dhe me standardet e pranuar të auditimit të brendshëm.
- d) Përcakton dhe zhvillon një sistem bashkëkohor për raportimin e rezultateve për të gjithë veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, në funksion të hartimit të raporteve periodike, përfshi edhe atë vjetor;
- dh) Kryen misione audituese për raste të veçanta, në shkallë sektoriale, kur vërehen dhe kërkohen nga menaxhimi i lartë. Kryerja e misioneve në institucionet e pavarura dhe organet e pushtetit vendor bëhet vetëm në bashkëpunim me strukturat e tyre audituese dhe, në mungesë të tyre, nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit;
- e) Mbikëqyr dhe vlerëson veprimtarinë e strukturave audituese në të gjitha subjektet e audituara, në përputhje me standardet dhe kërkesat e manualit, me metodat dhe udhëzimet e miratuara nga ministri i Financave;
- ë) Ndërmerr masat e nevojshme korrigjuese, në bashkëpunim me drejtuesit e auditimit të subjekteve të audituara, sipas urdhrit të drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit;
- f) Harton dhe zhvillon strategjitë dhe politikat kombëtare për sistemin e edukimit të përditësuar, në

trajnimin e vijueshëm, të detyrueshëm dhe procedurat e punësimit të audituesve;

g) Miraton metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të auditimit të brendshëm, të paraqitura nga njësitë e auditimit të subjekteve të audituara;

gj) Bashkëpunon me njësitë e personelit të institucioneve, për të përcaktuar kriteret e rekrutimit të audituesve;

h) Bashkëpunon me drejtuesit e njësisë së auditimit të brendshëm të subjekteve të audituara dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi, jep mendim për emërimin, lirimin dhe lëvizjen e audituesve në institucionet qëndrore, si dhe për emërimin, lirimin dhe lëvizjen e drejtuesve të njësisve audituese në njësitë vartëse;

i) Përcakton formën e regjistrimit për evidentimin e rekomandimeve të lëna nga strukturat e auditimit të subjekteve të audituara.

KREU IV

PËRGJEGJËSITË E MINISTRIT TË FINANCAVE DHE TË DREJTUESVE TË SUBJEKTEVE PUBLIKE PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Neni 14

Përgjegjësitë e ministrit të Financave në veprimtaritë audituese

Ministri i Financave është përgjegjës për:

- a) bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- b) ngritjen dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në sektorin publik, duke i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve nënligjore për këtë qëllim;
- c) miratimin e politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm, të propozuara nga drejtori i Përgjithshëm i Auditimit dhe të miratuara nga komiteti i auditimit të brendshëm;
- ç) emërimin dhe lirimin nga detyra të anëtarëve të komitetit të auditimit të brendshëm sipas pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji;
- d) dhënien e mendimit për emërimin, largimin dhe lirimin e drejtuesve të njësisve të auditimit në subjektet e audituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- dh) paraqitjen në Këshillin e Ministrave të raportit vjetor për auditimin e brendshëm, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, si dhe të raporteve të tjera, kur një gjë e tillë kërkohet;
- e) detyra të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 15

(vijon në faqen 11)

Projektligji "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"

(vijon nga faqja 10)

Përgjegjësitë e drejtuesve të subjekteve publike për auditimin e brendshëm

Ministrat dhe drejtuesit e subjekteve publike janë përgjegjës për:

- a) ngritjen e sistemeve të besueshme të kontrollit të brendshëm për realizimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për përbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe përdorimin e tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- b) hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit apo drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i raportit final;
- c) ndreqjen e parregullsive të vërejtura nga auditimet e kryera dhe marrjen e masave, disiplinore ose administrative, për personat përgjegjës;
- ç) respektimin e kriterëve të marrjes në punë të audituesve, të hartuara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit;
- d) kryerjen e detyrave të tjera, të parashikuara me ligj. KREU V

Neni 16

E drejta e ngritjes së njësisë të auditimit të brendshëm

Njësitë e auditimit të brendshëm krijohen për të realizuar veprimtarinë e auditimit të brendshëm, brenda subjekteve të audituara. Kriteret për ngritjen e këtyre njësive miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave.

Njësitë e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara kanë varësi të dyfishtë. Ato raportojnë drejtpërdrejt në organin e emërtesës dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurat e miratuara nga ministri i Financave. Këto struktura nuk janë pjesë e strukturave operative të subjekteve.

Audituesit e brendshëm janë nëpunës, të cilët emërohen në përputhje me kërkesat e shpallura në nenin 18, të këtij ligji.

Neni 17

Detyrat e njësive të auditimit të brendshëm

- Detyrat e njësive të auditimit të brendshëm janë:
1. Hartimi i metodave apo udhëzimeve për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit apo të akteve të tjera të Ministrisë së Financave, dhe dërgimi i tyre për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit.
 2. Hartimi i planeve, vjetore dhe strategjike, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

3. Kryerja e veprimtarive të auditimit të brendshëm, të cilat kanë qëllim të vlerësojnë se sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit financiar, si dhe performanca në subjektin e audituar janë transparente, përputhen me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë.

4. Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre audituese, si dhe dhënia e informacionit për Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre.

5. Përgatitja e raporteve, periodike dhe vjetore, dhe dërgimi i tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara prej saj dhe të miratuara nga ministri i Financave. Raportet përmbledhëse, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me evidencat e raportimit për periudhën raportuese, në mënyrë progresive, dhe një vlerësim përmblyllës për veprimtarinë audituese për këtë periudhë.

6. Raportimi, pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, të drejtuesit të subjektit të audituar, dhe i njësisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime, që përbëjnë vepër penale.

Ministria e Financave, drejtuesi i subjektit të audituar dhe drejtuesi i njësive të auditimit sigurojnë mundësi për edukimin e përditësuar dhe kualifikimin e vazhdueshëm, të detyrueshëm, të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 19, të këtij ligji.

KAPITULLI VI

AUDITUESI I BRENDSHËM

Neni 18

Kushtet e përzgjedhjes së audituesve

1. Punësimi i audituesve bëhet në përputhje me procedurat e caktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", për institucionet, që kanë punonjës, të cilët e kanë përfituar statusin e nëpunësit civil. Përveç kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në ligjet në fuqi, punësimi në njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik kërkon që audituesit të përzgjidhen ndërmjet personave që:

- a) kanë mbaruar studimet e larta universitare në njërin nga degët ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi ose disiplina të tjera, të cilat gjykohen nga drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të nevojshme për sektorin që auditohet;
- b) kanë përvojë pune jo më pak se tre vjet në auditim apo në fusha të tjera, si financë, kontabilitet dhe në ato të përcaktuara në shkronjën "a", të këtij neni;

(vijon në faqen 12)

Projektligji “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

(vijon nga faqja 11)

c) kanë mbaruar studimet në njëhën nga shkencat ekonomike, për emërtimet “Drejtor i njësisë së auditimit” dhe “Inspektor i lartë i auditimit”.

2. Për punësimin e audituesve dhe të drejtuesve të auditimit, deri në fund të periudhës dyvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zbatohen kriteret e përmendura në shkronjat “a”, “b” e “c”, të këtij neni. Pas kalimit të kësaj periudhe, për të gjithë punonjësit e auditimit, përzgjedhja bëhet ndërmjet personave, që përveç shkronjave “a”, “b” e “c”, të këtij neni, kanë kaluar me sukses edhe provimet e kualifikimit, para një komisioni, dhe janë pajisur me certifikatën: “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Neni 19

Trajnimi i audituesve

Të gjithë audituesit në detyrë, sipas kriterëve të vendosura në nenin 18, të këtij ligji, i nënshtrohen edukimit të përditësuar dhe kurseve të kualifikimit, të vijueshme e të detyrueshme, të cilat programohen dhe menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit.

Komisioni i kualifikimit, si njësi përgjegjëse për kualifikimin dhe certifikimin e audituesve të brendshëm, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave. Në vendim përcaktohen rregullat e funksionimit dhe shpërblimi i anëtarëve të kësaj njësie.

Neni 20

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

1. Të njohin, respektojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet, ligjore dhe nënlige, në fuqi dhe me standardet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

2. Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, me profesionalizëm dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, sipas normave dhe procedurave të veçanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

3. Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin, i cili miratohet nga ministri i Financave dhe nënshkruhen nga secili auditues.

4. Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.

5. Të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me planin vjetor, të miratuar, me përjashtim të rasteve kur janë miratuar ndryshime të paparashikuara nga titullari.

6. Të propozojnë drejtuesit të njësisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin, deri në shqyrtimin nga organi përkatës, të veprimeve të kundërligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e

subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale.

7. Të japin rekomandime subjektit të audituar për ndrejten e parregullive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e dëmeve, ekonomike dhe financiare, për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjnë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

8. Të mos bëjnë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar.

9. Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.

Neni 21

Të drejtat e audituesve

Audituesit në kryerjen e misionit të tyre kanë të drejtat e mëposhtme:

1. Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit.

2. Të kërkojnë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të marrin nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklarata dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit.

4. Të ndjekin, në mënyrë periodike, edukimin e përditësuar dhe trajnimin e vazhdueshëm të detyrueshëm, sipas kërkesave të paragrafit të parë, të nenit 19, të këtij ligji për funksionet e veçanta që ushtrojnë, si dhe në fusha të tjera, brenda shërbimit publik.

5. Të kërkojnë drejtuesit të njësisë së auditimit heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cënohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit.

Neni 22

Kufizimet në veprimtarinë e audituesve

Audituesve u ndalohe:

(vijon në faqen 13)

Projektligji "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"

(vijon nga faqja 12)

- a) të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike;
- b) të kryejnë detyra, brenda subjektit të audituar, që nuk kanë të bëjnë me funksionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë, ose të kenë përfitime të tjera, të natyrave dhe formave, që i bëjnë të jenë në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.

Neni 23

Konflikti i interesave për audituesit

1. Audituesi njofton paraprakisht, me shkrim, drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm për çdo konflikt të mundshëm interesi, që rrjedh nga pjesëmarrja e tij në auditimin e një subjekti. Me konflikt interesash kuptohet:

- a) punësimi si auditues gjatë 3 (tre) viteve të fundit në subjektin, që do të auditohet;
- b) punësimi në funksione drejtuese gjatë 3 (tre) viteve të fundit në subjektin, që do të auditohet, të audituesit, bashkëshortes/bashkëshortit, të të afërmeve me lidhje gjinie deri në shkallën e dytë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil;
- c) zotërimi nga audituesi, bashkëshortja/bashkëshorti, të afërmit me lidhje gjinie, deri në shkallën e tretë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil, i aksioneve ose pjesëve të kapitalit në subjektin publik, që do të auditohet;
- ç) rrethana të tjera të caktuara, që mund të mbartin konflikt interesash, kur gjykohen si të tilla dhe arsyetohen me shkrim nga drejtori i Përgjithshëm i Auditimit ose drejtuesi i njësisë së auditimit.

2. Nëse vërtetohet se në auditim kanë marrë pjesë një ose më shumë auditues, që janë në konflikt interesash, siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, drejtori i Përgjithshëm i Auditimit ose drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm mban qëndrim ndaj audituesit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjeve të tjera, anulon auditimin, si dhe kërkon përsëritjen e tij.

KAPITULLI VII

MARRËDHËNIET E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AUDITIMIT ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 24

Marrëdhëniet me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Presidencën dhe institucionet e pavarura

Drejtorja e Përgjithshme e Auditimit bashkëpunon me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Presidencën dhe institucionet e pavarura në rrugë zyrtare, për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në këto institucione. Strukturat audituese të këtyre institucioneve janë të detyruara të dërgojnë programet,

vjetore dhe strategjike, të auditimit dhe të raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me procedurat e miratuara nga ministri i Financave. Institucionet e pavarura, që nuk plotësojnë kriteret për të ngritur njësi audituese, auditohen nga njësi përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit.

Neni 25

Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe/ose organet e tjera të lidhura me auditimin

Drejtorja e Përgjithshme e Auditimit bashkëpunon me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe/ose organet e tjera, të lidhura me auditimin. Ky bashkëpunim synon në shkëmbimin e çdo informacioni të vlefshëm, që lidhet me sistemin e auditimit, në dërgimin e programeve vjetore të auditimit, për të shmangur mbivendosjet në procesin e auditimit, dhe në dërgimin e raporteve përmbledhëse, vjetore e periodike, kur kërkojnë nga palët.

Neni 26

Marrëdhëniet me ministrin e linjës, institucionet qëndrore dhe organet e pushtetit vendor

Drejtorja e Përgjithshme e Auditimit bashkëpunon, në rrugë zyrtare, me njësitë e auditimit pranë ministrive të linjës, institucioneve qëndrore dhe organeve të pushtetit vendor. Strukturat audituese të këtyre institucioneve janë të detyruara të dërgojnë programet, vjetore e strategjike, të auditimit dhe të raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me procedurat e miratuara nga ministri i Financave.

Neni 27

Përgatitja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 11 e 19.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 14 e 16.

Neni 28

Shfuqizimet

Ligji nr.9009, datë 13.2.2003, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", shfuqizohet.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Programi i Punimeve të Kuvendit për periudhën 15 janar - 19 mars 2007

1. P/Ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira”.

*Paraqitur nga një grup deputetësh më
24.11.2005*

2. P/Ligji “Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitikë”.

(Është shtyrë shqyrtimi më 5.06.2006 për arsye që të shqyrtohet kur të vijë edhe p/ligji nga Qeveria).

*Paraqitur nga një grup deputetësh të LSI-së, më
26.01.2006*

3. Dekret nr. 4778, datë 16.02.2006 “Për kthimin e ligjit nr. 9467, datë 30.01.2006 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 13.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

Paraqitur më 17.02.2006

4. P/Ligji “Akti i Lirisë së Shtypit”.

Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 20.02.2006

5. P/Ligji “Për një ndryshim të ligjit nr. 7941, datë 31.05.1995 “Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Paraqitur nga një grup deputetësh më 9.03.2006

6. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001

“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 3.04.2006

7. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Paraqitur nga KM, më 6.06.2006

8. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike”. (Është diskutuar, por është shtyrë votimi).

Paraqitur nga KM, më 20.06.2006

9. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Paraqitur nga KM, më 4.07.2006

10. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 29.01.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.

Paraqitur nga KM, më 29.09.2006

11. P/Ligji “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Paraqitur nga KM, më 29.09.2006

12. P/Ligji “Për organizimin, funksionimin, procedurat dhe detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësim-it”.

Paraqitur nga KM, më 4.10.2006

13. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Paraqitur nga një grup deputetësh më 13.10.2006

14. P/Ligji “Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të zgjedhurve”.

*Paraqitur nga grupi parlamentar i PD-së, më
25.10.2006*

15. P/Ligji “Për verifikimin e të qenit bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete shqiptare para datës 31.12.1992, të funksionarëve të lartë publikë”.

*Paraqitur nga grupi parlamentar i PS-së, më
26.10.2006*

16. P/Ligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit”.

Paraqitur nga deputeti Nard Ndoka

17. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për Veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Paraqitur nga KM, më 2.11.2006

18. P/Ligji “Për dhënie amnistie”.

Paraqitur nga një grup deputetësh, më 7.11.2006

19. P/Ligji “Për dhënie amnistie”.

(vijon në faqen 15)

Programi i Punimeve të Kuvendit për periudhën 15 janar - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 14)

Paraqitur nga KM, më 21.11.2006

20. P/Ligji “Disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Paraqitur nga një grup deputetësh të opozitës, më 16.11.2006

21. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Paraqitur nga një grup deputetësh të opozitës, më 16.11.2006

22. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Paraqitur nga një grup deputetësh të opozitës, më 16.11.2006

23. P/Ligji “Për Policinë e Shtetit”.

Paraqitur nga KM, më 22.11.2006

24. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Paraqitur nga deputeti B. Nishani, më 30.11.2006

25. P/Ligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.

Paraqitur nga KM, më 18.12.2006

26. P/Ligji “Për Fondin Kullosor”.

Paraqitur nga KM, më 18.12.2006

27. Struktura e Autoritetit të Konkurrencës.

Paraqitur nga KM, më 27.11. 2006

28. Struktura e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Paraqitur nga KM, më 26.11.2006

29. P/ Ligji “Për Portat turistike në Republikën e Shqipërisë”.

Paraqitur nga KM, më 28.12.2006

30. P/ Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të Portit të peshkimit, Durrës, Shqipëri”.

Paraqitur nga KM, më 28.12.2006

31. P/ Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ajror”.

Paraqitur nga KM, më 29.12.2006

32. Struktura Organizative dhe numri i punonjësve të ERE-s.

Paraqitur më 26.12.2006

33. P / Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare”.

Paraqitur nga KM, më 9.01.2006.

34. P / Ligji “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

Paraqitur nga KM, më 11.01.2007

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit

Ditmir Bushati
Denis Gila
Klesta Hysi
Lindita Troka
Florjan Kalaja
Ermal Markaj

Stafi i Projektit

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities

Ditmir Bushati
Denis Gila
Klesta Hysi
Lindita Troka
Florjan Kalaja
Ermal Markaj

Project Staff

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org